

**STATUTI I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"MIKA MAAHAN" SH.P.K**

**Neni 1**

Sipas ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe ndermarrjet tregtare" dhe ligjet ne fuqi në Republikën e Shqipërisë, ortaket themelues:

Riccardo Carlassare, lindur më datë 19.07.1962, ne Vizneca, banues ne Quinto Vicentino, Via Matri di Nassirya 6, qytetar italian, identifikuar me pashaportë Nr. YA3679502, e vlefshme deri më 20.12.2022, me kapacitet të plotë juridik për të vepruar.

Dhe

Elia Marsura, lindur me date 22.07.1990, ne Asolo, banues ne Via Contrado della Misericordia nr. 28, Vincenca, Itali, qytetar italian, identifikuar me passaporte nr. YA4411604, e vlefshme deri me 15.07.2023, me kapacitet te plote per te vepruar;

Vendosin sot të themelojë shoqerine me pergjegjesi te kufizuara " MIKA MAAHAN" sh.p.k.

**Neni 2**

**Emri i Shoqerise**

Shoqëria do të mbajë emrin "MIKA MAAHAN" sh.p.k. këtu dhe siç raportohet më poshtë.

**Neni 3**

**Forma ligjore**

Shoqëria do të ketë formën e vet ligjore, shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar në pajtim me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 4**

**Kohëzgjatja**

Aktiviteti i shoqërisë do të fillojë në datën e regjistrimit në QKB. Veprimtaria e shoqërisë do të zgjasë deri me 15.03.2024. Kohezgjatja e shoqerise mund te zgjatet me vendim te ortakeve themelues.

**Neni 6**

**Selia**

Shoqëria do të ketë zyrën e saj në: Rruga Tre Vllezerit Kondi, nr. 6, kati 1, Tirane.

Shoqëria ka të drejtën të themelojë degë dhe përfaqësi në të gjithë territorin e Rrepublicës së Shqipërisë dhe jashtë vendit, me vendim të ortakëve themelues.

Shoqëria ofron mundësinë për të marrë pjesë në kompani të tjera ekzistuese ose të ardhshme që do të zhvillojnë aktivitetin në territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë vendit me vendimin e ortakëve themelues.

**Neni 7**

**Objekti**

Objekti i shoqërisë do të jetë:

- a) prodhim software
- b) sherbime mirembajtje software
- c) hedhje dhe perpunim te dhenash
- d) sherbime aksesit per perdorues te ndryshem ne cilesine e klientit apo perdoruesit pa pagese ne vartesi te programit
- e) Konsulence te cdo tipi per shoqerite tregtare nderkombetare,
- f) Trainim dhe Formim profesional ne fushen e programacionit

Shoqëria mund të marre dhe të jaoe hua për pale të treta apo nga pale të treta institucione financiare apo jo, me qëllim zhvillimin e objektit të saj të metejshëm.

#### **Neni 8**

##### **Kapitali themeltar i Shoqërisë**

Kapitali i shoqërisë do të jetë 20.000.000 leke,

Z. Riccardo Carlassare zotëron një kuotë, ekuivalente me 80% të kapitalit themeltar, të barabartë me 16.000.000 lekë vlerë nominale.

Z. Elia Marsura, zotëron një kuotë, ekuivalente me 20% të kapitalit themeltar, të barabartë me 4.000.000 lekë vlerë nominale.

Kapitali duhet të derdhet për maksimalisht brenda vit të parë nga ortaket sipas vlerës respektive.

Ortakët mund të rrisin ose zvogëlojnë kapitalin në masën e lejuar nga ligji, ose të ndryshojë formën ligjore të shoqërisë.

#### **Neni 9**

##### **Transferimi i kuotave të zotëruara në kapitalin themeltar të shoqërisë.**

Pjesët e kapitalit mund të transferohen lirish ndërmjet personave juridikë ose fizikë me anë të një kontrate ndërmjet palëve.

Pjesët e kapitalit mund të transferohen palëve të treta, pasi të jenë refuzuar nga ortakët aktualë e drejta e parablerjes.

Pjesë e kapitalit janë në rrugë trashëgimie lirish të transferueshme, pas vendimit të ortakëve për transferimin e pjesës së kapitalit tek trashëgimtarët.

#### **Neni 10**

##### **Asambleja e shoqërisë**

Asambleja e shoqërisë është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë. Ajo ka për detyrë si vijon:

- a. miratimi i politikave të shoqërisë
- b. ndryshimi ose modifikimi i statutit të shoqërisë
- c. emërimin ose shkarkimin e administratorëve dhe përcaktimin e kompetencave të tyre
- d. emërimin ose shkarkimin e auditorëve
- f. përcakton kompesimin e personave të përmendur në paragrafin c, d.
- e. ndryshimi i selisë
- f. ndryshimi i emrit të shoqërisë
- g. rritjen ose uljen e kapitalit të shoqërisë
- k. ndarjen ose anulimin e kuotave të shoqërisë
- h. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- i. miratimin e rregullave procedurale për mbledhjen e asamblesë
- j. të tjera të përcaktuara nga dispozitat ligjore në fuqi ose statuti

Asambleja e Përgjithshme do të thirret në formë të shkruar me postë rekomandë, ose nëpërmjet çdo poste të çertifikuar të dërguar nga administratori në rastin që kërkohet nga ai dhe në çdo rast tjetër.

Komunikimi duhet të përmbajë vendin, kohën e takimit dhe orën e mbledhjes, dhe duhet të komunikohet minimalisht 7 dite kalendrike përpara datës së organizimit të mbledhjes. Në rast se asambleja nuk mbledhet në zbatim të sa në paragrafin 1 të këtij neni, ajo quhet e vlefshme kur të gjitha palët bien dakord edhe në rast parregullsie.

#### **Neni 11**

##### **Administrimi i Shoqërisë**

Administrimi i shoqërisë i është besuar një administratori të vetëm.

Administratori menaxhon punën e përditshme të shoqërisë dhe është përgjegjës për aktivitetet e mëposhtme:

EM



- Ekzekutimi i operacioneve të përditshme të shoqërisë,
- Përfaqësuesi i shoqërisë kundrejt palëve të treta, saktësisht ose me zëvendësim të caktuar me prokurë,
- Hartimi dhe mbajtja e pasqyrave financiare, propozimi i auditorëve, nëse është e nevojshme,
- Përgatitja e dokumentave në emër të shoqërisë,
- Përgatitja e kontratave të punësimit dhe zgjidhja e tyre sipas çdo çështje,
- Aktivitete të tjera të çdo lloji në dobi të shoqërisë dhe realizimit të objektit të saj.

Administrator i shoqërisë është Elia Marsura, lindur me date 22.07.1990, ne Asolo, banues ne Via Contrado della Misericordia nr. 28, Vincenca, Itali, qytetar italian, identifikuar me passaporte nr. YA4411604, e vlefshme deri me 15.07.2023 per nje periudhe kohore 5 vjecare.

#### **Neni 12**

##### **Ushtrimi**

Viti financiar i shoqërisë nis nga 1 janari dhe përfundon më 31 dhjetor.

Përjashtimisht, viti i parë i shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon 31 dhjetor.

#### **Neni 13**

##### **Të ardhurat, dividendët**

Shoqëria do të krijojë një fond rezervë për realizimin e objektit.

Fitimi pas përfundimit të vitit financiar dhe pas pagesës së tatimeve, mund të ndahet nga ortakët e shoqërisë.

#### **Neni 14**

##### **Shpërndarja dhe likuidimi**

Shpërndarja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a. Fundi i kohëzgjatjes së aktivitetit të parashikuar
- b. Me vendimin e mbledhjes së ortakëve
- c. Hapja e procedurave të falimentimit.
- d. Nëse nuk kryen aktivitet tregtar për dy vite të vazhdueshme dhe nuk është shpallur pezullimi i regjistruar në QKB.
- e. Me vendim gjyqi likuiduesi raporton mbi gjendjen e asetëve dhe detyrimeve të shoqërisë në operacionet e mëtejshme të shlyerjes dhe kohën e nevojshme për mbylljen e procesit. Në fund të këtij procesi, ortakët do të informohen për balancën dhe mbylljen e procedurës së likuidimit.

#### **Neni 15**

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë aktivitetit të shoqërisë, në qoftë se nuk zgjidhet miqësisht, palët do të drejtohen Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit, përveç kur kompetente për të zgjidhur mosmarrëveshjet në bazë të ligjit është gjykata shqipëtare.

E-mail i komunikimit me ortakët do të jetë: [info@abccconsulting.it](mailto:info@abccconsulting.it); [eliamarsu@gmail.com](mailto:eliamarsu@gmail.com)

Ortakët Themelues

Elia Marsura

Pierluigi Colaninno

18.02.19

EM

